



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2020

Periudha e Raportimit Janar - Gusht 2020

Në zbatim të nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore u krijua bazuar në ligjin nr. 111/2012, për “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar, VKM-së nr.221, datë 26.4.2018 për “Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore” si dhe Urdhrit nr. 152, datë 1.10.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 17, datë 30.01.2020 ku në përbërje të saj përveç zyrës qendrore të AMBU-së janë edhe katër Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore respektivisht ZABU Drin Bunë me qendër në Shkodër, ZABU Vjosë me qendër në Vlorë, ZABU Shkumbin Seman me qendër në Fier dhe ZABU Ishëm Erzen Mat me qendër në Tiranë. Aktualisht AMBU-ja ushtron aktivitetin e saj buxhetor në grupin 87 në programin buxhetor “Administrimi i Ujërave” me kod 05640.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me objektivat e AMBU-së, duke pasur si synim një përdorim më eficient të këtyre burimeve financiare sipas programimit të bërë për vitin buxhetor 2020.

I. SHPENZIMET KORENTE

Fondet buxhetore për vitin 2020 për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore në total janë 203,250,000 lekë, prej të cilave 103,000,000 lekë janë shpenzime korente dhe 100,000,000 lekë për shpenzime kapitale dhe 250,000 lekë janë parashikuar për transfertat për familjarë dhe individë. Sipas Aktit Normativ, Nr. 15, datë 15.04.2020 dhe Aktit normativ nr. 28 datë 02.07.2020, fondet buxhetore të institucionit u pakësuan në total me 24,100,000 lekë respektivisht 13,000,000 lekë nga art. 600; 2.00,000 lekë nga art. 601; për art. 602 fondet janë


pakësuar sipas produkteve: 3,900,00 lekë produkti 98708AA; 1,000,000 produkti 98708AB, 2,000,000 lekë produkti 98708AC, Gjithashtu janë pakësuar me 2,000,000 lekë shpenzimet kapitale (art. 230). Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelës më mëposhtë, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre, për periudhën Janar - Gusht 2020.

Tabela 1 Realizimi i shpenzimeve korente për periudhën Janar – Gusht 2020

Entiteti i qeverisjes	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Fakti	Diferenca	% e realizimit
AMBU	87	1	05640	600	71,760	58,760	33,244	25,516	57
AMBU	87	1	05640	601	11,820	9,820	5,567	4,253	57
AMBU	87	1	05640	606	250	250	-	250	0
AMBU	87	1	05640	602	19,420	12,320	3,904	8,416	32
AMBU	87	1	05640	98708AB	8,420	4,520	1,161	3,359	26
AMBU	87	1	05640	98708AB	5,000	4,000	1,750	2,250	44
AMBU	87	1	05640	98708AC	6,000	3,800	993	2,807	26
Totali					103,250	81,150	42,715	38,435	53

Grafiku i mëposhtëm paraqet realizimin e treguesve sipas artikujve për periudhën Janar – Gusht 2020.

Grafiku 1 Realizimi i treguesve të shpenzimeve korente për periudhën Janar – Gusht 2020



Referuar tabelës nr. 1, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për 8 mujorin e vitit 2020 është në masën 53%, në raport me fondet totale buxhetore, pas miratimit të Aktit normativ nr 15, datë 15.04.2020 dhe Aktit normativ nr. 28, datë 02.07.2020. Faktorët që kanë ndikuar në këtë vlerë realizimi janë të analizuar si më poshtë vijon:

Në artikullin 600 & 601 “Fondi i pagave dhe Sigurimeve shoqërore & shëndetësore” fondet janë realizuar, respektivisht nga 57% e buxhetit vjetor të ndryshuar.

Vlera e realizuar është për arsye të vendeve vakante të krijuara në institucioni si rezultat i ristrukturimit të tij. Njëkohësisht, i njëjti argument vlen edhe për realizimin e artikullit 601.

Në artikullin 602 “Shpenzime Operative” janë realizuar në masën 32% në raport me totalin e buxhetit të ndryshuar. Kjo vlerë vjen si pasojë e faktit të mos funksionimit me kapacitet të plotë të institucionit për arsye të vendeve vakante por edhe të mos kryerjes së shumë shpenzimeve të parashikuara në Rregjistrin e Prokurimeve Publike si rezultat i situatës së aktuale të pandemisë të shkatuar nga COVID -19. Gjithashtu edhe vonesa në miratimin VKM lidhur me pagesat e anëtarëve të Këshillave të Baseneve Ujore është një tjetër arsye e mos realizimit optimal të buxhetit të parashikuar për shpenzimet korente sidomos në produktin e parë, ku ka qënë i alokuar ky buxhet. Si rrjedhim, pjesa e mbetur e shpenzimeve do të të realizohen në periudhën në vijim.

II. INVESTIMET


Tabela 2 Realizimi i investimeve për periudhën Janar – Gusht 2020

(000 lekë)

Entiteti i qeverisjes	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i projektit	Buxheti vjetor	Fakti	% e realizimit
Menaxhimi i Integruar i burimeve ujore (Projekti ADA & BE)	87	2	05640	231	18 AQ 001	93,000	38,346	41
TVSH (Projekti ADA & BE)	87	4	05640	231	18 AQ 002	2,000	732	37
Pajisje të blera	87	1	05640	231	18 AQ 101	3,000	1,493	50
Total						98,000	40,572	41

Referuar informacionit të Tabelës 2, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale për 8 mujorin e vitit 2020 është në masën 41% e fondit të të alokuar (pas ndryshimeve sipas akteve normative). Projekti “Menaxhimi i Integruar i burimeve ujore (Projekti ADA & BE) i cili është financim i huaj me kod 18AQ001 si dhe TVSH e tij me kod 18AQ002 është në vazhdim dhe janë realizuar respektivisht në masën 41% dhe 37% të vlerës totale. Projekti “Pajisje të blera” me kod 18AQ101 është realizuar në masën 50% dhe vjen si rezultat i realizimit të kontratës së njoftuar në Janar të këtij viti (realizim i procedurës së prokurimit nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara gjatë fundit të vitit 2019). Pjesa e mbetur e këtij investimi është në proces për blerjen e pajisjeve të tjera.

Grafiku 2 Realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën Janar – Gusht 2020



III. Objektivat për vitin 2020

Objektivi kryesor i institucionit është: Sigurimi, mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i burimeve ujore

Realizimi i objektivave nënkupton realizimin e aktiviteteve dhe produkteve, të pasqyruara në PBA për vitin buxhetor 2020.

Në funksion të realizimit të objektivave janë kryer aktivitetet dhe realizuar produktet si më poshtë vijon:

Produkti A: Akte ligjore dhe nënligjore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore

– me kod 98708AA është realizuar në masën 54 % nga ana buxhetore, duke ditur se në këtë produkt janë parashikuar edhe fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqerore si edhe shpenzimeve operative ku një vlerë të konsiderushme ka edhe parashikimi i pagesës për anëtarët e Këshillave të Baseneve Ujore, pagesa të cilat nuk janë kryer pasi ende nuk është miratuar VKM përkatëse për këto pagesa.

Ndërkohë sa i takon aktivitetit kryesor të këtij produkti në matricën e akteve në ndryshim nga PBA, janë planifikuar 17 të tilla nisur nga fakti që një pjesë do të hartohen nga projekti EUSIWM. Planifikimi i miratimit të akteve është bërë për 3 katërmujor. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 6 akte nga të cilat 4 në katërmujorin e parë dhe 2 në katërmujorin e dytë të vitit 2020. Në vijim, 12 akte janë parashikuar për miratim katërmujorin e tretë nga këto, 9 akte janë duke u realizuar nga projekti EUSËINM dhe 3 akte (tarifat administrative, tarifat e përdorimit dhe funksionimi i kadastrës) nga AMBU.

Produkti B: Sistemi i funksionimit të Sistemit të Kadastrës Kombëtare të Ujit i përmirësuar – me kod 98708AB është realizuar në masën 44% të fondeve buxhetore të rishikuara për 2020. Nga ana tjetër, sqarojmë se "sasia" e realizuar për 8 mujorin që raportojmë konsiston në punën paraprake që është zhvilluar për disponimin dhe standardizimin e dokumenteve/të dhënave të gatshme për t'u hedhur në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore (KKBU) dhe publikimin e tyre aktualisht në protalin e ASIG, dhe nuk reflektohet në të dhënat që hidhen konkretisht në KKBU. Arsyet e realizimit "pjesërisht", dmth mos hedhjes në KKBU, janë: (1) Moduli Editor i KKBU nuk është funksional dhe për rrjedhim pasqyrimi i të dhënave në KKBU nuk mund të realizohet. Janë në proces procedurat për kontraktimin e shërbimit të mirëmbajjes dhe upgrade të KKBU nga AKSHI, nëpërmjet të cilave mund të zgjidhet dhe problemi; (2) funksionimi i procesit të hedhjes së të dhënave nga institucionet gjeneruese në KKBU duhet të formalizohet nëpërmjet akteve nënligjore që do të rregullojnë procesin, të cilat aktualisht janë në fazën e hartimit në bashkëpunim me konsulentin (projekti "Për krijimin e platformës institucionale dhe rregullatore për qeverisjen dhe funksionimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore").

Produkti C: Zbatimi i politikave dhe i dokumentave strategjik dhe planifikues, me qëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore – me kod kod 98708AC është realizuar në masën 26% e fondeve buxhetore të rishikuara.

Në numrin e dokumenteve të miratuara (leje/autorzime) janë përfshirë edhe dokumentet e mirëfilltë strategjik/panifikues të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit. Viojmë të informojmë se situata e krijuar nga Covid-19 ka ndikuar drejtpërdrejtë në realizimin e këtij objekti për periudhën mars-qershor). Situata kryesisht ka ulur numrin e aplikimeve, mundësinë e organizimit të mbledhjeve të këshillave të baseneve ujore në të cilat merret vendimet për lejet/autorizimet dhe verifikimin paraprak në terren të parametrave të deklaruar nga subjektet aplikuese.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
GERTA LUBONJA



Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve
Per 8 mujorin e vitit 2020

ne 000 leke

Ministria	Agjencia e menaxhimit te Burimeve Ujore		Kodi	1087016			
Programi	Administrimi I Ujerave		Titulli	05640			
Totali Shpenzimeve							
Artikulli	Kod produkti	(1) MTBP Plan 2020	(2) Buxheti 2020	(3) Buxheti Rishikuar 2020	(4) Fakti 8 mujori I vitit 2020	(5)=(2)-(4) Diferenca	
600	98708AA	Paga	71.760	71.760	58.760	33.244	25.516
601	98708AA	Sigurime Shoqërore	11.820	11.820	9.820	5.567	4.253
	98708AA	Mallra dhe Shërbime të Tjera	8.420	8.420	4.520	1.161	3.359
602	98708AB	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5.000	5.000	4.000	1.750	2.250
	98708AC	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6.000	6.000	3.800	993	2.807
603		Subvencione					0
604		Transfera Korente të Brendshme					0
605		Transfera Korente të Huaja					0
606	98708AA	Trans per Buxh. Fam. & Individ	250	250	250	0	250
Neu-Totali		Shpenzime Korrente	103.250	103.250	81.150	42.715	38.435
230		Kapitale të Patruçuara	2.000	2.000	0	0	0
	18AQ202	Hartimi I PMBU Shkumbin	2.000	2.000	0		0
231		Kapitale të Trupçuara	98.000	98.000	98.000	40.572	57.428
	18AQ101	Pajisje te blera	3.000	3.000	3.000	1.493	1.507
	18AQ001	Projekti BE - ADA	93.000	93.000	93.000	38.346	54.654
	18AQ002	TVSH per projektin BE - ADA	2.000	2.000	2.000	732	1.268
Neu - Totali		Shpenzime Kapitale	100.000	100.000	98.000	40.572	57.428
Totali		Korrente dhe Kapitale	203.250	203.250	179.150	83.287	95.863

Shpenzime Korrente	
Shpenzime Kapitale	
Gjithsej	

Ne %	Ne %
53	53
41	41
46	46

Drejtesesi i EMP	Emri	Titullari Institucionit	Emri	Gerta Babonja
	Firma		Firma	
	Data		Data	

Alban Tokes
14.9.2020



**Formati nr.7 : Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve
 Per 8 mujorin e vitit 2020**

ne 000 leke

Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore

Kodi i Grupit


87

Shpenzimet e Ministrise

		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(2)-(4)
Programet		PBA	Buxheti	Buxheti i	Fakti	Diferenca
Titulli		Plan 2020	2020	Rishikuar 2020	2020	2020
05640	Administrimi I ujtave	203.250	203.250	179.150	83.287	95.863
Totali Institucioni Buxhetor		203.250	203.250	179.150	83.287	95.863


Drejtesi i EMP	Emri	Titullari Institucioni	Emri
	Firma		Firma
	Data		Data

Gerta Lubonja



**Formati Nr. 8 : Raporti i Realizimit te Produktave te Programit
Per 8 mujorin e vitit 2020**

Ministria		Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore		Kodi	1087016			
Programi		Administrimi I Ujerve		Titulli	05640			
Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Njësia Matëse	Sasia e planifikuar per vitin 2020	Sasia e realizuar deri sot	Analiza e Realizimit			Komente
					Profesisht	Pjesërisht	Aspak	
98708AA	Akte ligjore dhe nentligjore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore	Numer aktesh	8	6	✓			<p>Ne matricen e akteve ne ndryshim nga PBA jane planifikuar 17 te tilla nisar nga fakti qe nje pjese do te hartohen nga projekti EUSIWM. Planifikimi i miratimit te akteve eshte bere per 3 katermujorin. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 6 akte nga te cilat 4 ne katermujorin e pare dhe 2 ne katermujorin e dyte te vitit 2020. Ne vijim, 12 akte jane parashikuar per miratimin katermujorin e tret nga keto 9 akte jane duke u realizuar nga projekti EUSWINM dhe 3 akte (tarifat adm, tarifat e perdorimit dhe funksionimi i kadasres) nga AMBU.</p> <p>Sqarojme se "sasia" e realizuar për 8 mujorin që raportojmë konsiston në punën paraprake që është zhvilluar për disponimin dhe standardizimin e dokumenteve/të dhënave të gatshme për t'u hedhur në Kadasren Kombëtare të Burimeve Ujore (KKBU) dhe publikimin e tyre aktualisht në portalin e ASIG, dhe nuk reflektohet në të dhënat që hidhen konkretisht në KKBU. Arsyejt e realizimit "pjesërisht", dntih mos hedhjes në KKBU, janë: (1) Moduli Editor i KKBU nuk është funksional dhe për rrjedhim pasqyrimi i të dhënave në KKBU nuk mund të realizohet. Janë në proces procedurat për kontraktimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe upgrade të KKBU nga AKSHI, nëpërmjet të cilave mund të zgjidhet dhe problemi; (2) funksionimi i procesit të hedhjes së të dhënave nga instancionet gjeneruese në KKBU duhet të formalizohet nëpërmjet akteve nentligjore që do të rregullojnë procesin, të cilat aktualisht janë në fazën e hartimit në bashkëpunim me konsulentin (projekti "Për krijimin e platformës institucionale dhe rregullatore për qeverisjen dhe funksionimin e Kadasres Kombëtare të Burimeve Ujore").</p> <p>Në numrin e dokumenteve të miratuarra (leje/autorizime) janë përfshirë edhe dokumentet e mirëfilltë strategjik/panifikues të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit. Vërejmë tw informojmë se situata e krijuar nga Covid-19 ka ndikuar drejtpërdrejtë në realizimin e këti objekti për periudhën mars-qershor). Sitata kryesisht ka ulur numrin e aplikimeve, amandësime e organizimit të mbledhjeve të keshillave të baseneve ujore në të cilat merret vendimet për leje/autorizimet dhe verifikimin paraprak në terren të parametrave të deklaruara nga subjektet aplikuese.</p>
98708AB	Sistemi i furnizimit me të dhëna i Kadasres Kombëtare të Ujit i përmirësuar	% e të dhënave	25%	1/3	✓			
98708AC	Zbatimi i politikave dhe i dokumentave strategjik dhe planifikues, me qëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore	Nr-leje/autorizime	330	46	✓			


Dejtuasi	Emri		Titullari Institucionit	Emri	
	Firma	Data		Firma	Data
	<i>Albanus Tolun</i>			<i>Gerta Luloopja</i>	
	<i>04.10.8.20</i>				

**Formati nr.9 : Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produktëve
 Per 8 mujorin e vitit 2020**

ne 000 leke

Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore							Kodi	87
Administrimi I Ujërave							Titulli	05640
Programi	Kodi i	Produktit	Emri i Produktit	PBA Plan 2020	(1)		Mbjetja (1-2)	% Realizimit
					Buxheti 2020 rishikuar 2020	Fakti Janar-Gusht 2020		
98708AA			Akte ligjore dhe nënligjore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore	92.250	73.350	39.972	33.378	54
98708AB			Sistemi i furnizimit me të dhëna i Kadastrës Kombëtare të Ujit i përmirësuar	5.000	4.000	1.750	2.250	44
98708AC			Zbatimi i politikave dhe i dokumentave strategjik dhe planifikues, me gëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore	6.000	3.800	993	2.807	26
				103.250	81.150	42.715	38.435	53

Drejtuessi	Emri	Gerta Lubonja	
	Firma		
	Data	14.9.20	
	Titullari		
	Institucionit		



Formati nr.10 : FORMULARI I MONITORIMIT TE INVESTIMEVE
 Per 8 mujorin e vitit 2020

Në mijë lekë

	<i>Emertimi i Projektit</i>	<i>Kodi I Projektit</i>	<i>Buxheti 2020</i>	<i>Fakti</i>	<i>Realizimi ne %</i>	<i>Komentet (Problematika)</i>
	TOTALI		98.000	40.572	41	
	Menaxhimi i Integruar i burimeve ujore					
1	(Projekti ADA & BE)	18AQ001	93.000	38.346	41	
2	TVSH (Projekti ADA & BE)	18AQ002	2.000	732	37	
3	Pajisje të blera	18AQ101	3.000	1.493	50	

Drejtuessi i EMP	Emri		Titullari I Institucionit	Emri		Gerta Lubonja
	Firma			Firma		
	Data			Data		

Alcolpa Tole

14.9.20

